



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:151430

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05428014

Rev.nr.68/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Zenel Leku, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nenad Lazic, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të e paditëses/propozueses Radio Televizioni i Kosovës (RTK), me seli në P., rruga “Xhemajl Prishtina”, nr. 12, kundër të paditurve/kundërpropozuesve 1. D.Sh nga P., “L.B”, ../, dhe 2. trashëgimtarët e paditësit, me adresë në rrugën “L.B”., .../ P., sipas padisë për konfiskimin e përhershëm të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me revizionin e paditëses/propozueses, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5890/23, të datës 04.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditëses/propozueses R.T. K (RTK), me seli në P., i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5890/23 të datës 04.10.2023.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4176/23 të datës 21.08.2023, është hedhë poshtë padia dhe propozimi për caktimin e masës së sigurisë C.nr.4176/23 të datës 11.07.2023, të paraqitura nga ana e paditëses/propozueses R.T.K, me seli në P., kundër të paditurve/kundërpropozuesve 1. D. Sh.,nga P., dhe 2. trashëgimtarët e paditësit me adresë Ll.B., ,,/..., P., për shkak të mosplotësimit.

Gjykata e Apelit të Kosovës, në procedurën e ankesës kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, me aktvendimin Ac.nr.5890/23 të datës 04.10.2023, ka vendosur që të refuzoj të pa themeltë ankesën e paditëses-propozueses, R.T., i K., (RTK), me seli në P., ndërsa ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4176/23 të datës 21.08.2023.

Kundër këtij aktvendimi i paditësja/propozuesja, përmes të autorizuarit të saj, në afat ligjor ka paraqitë revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të aprovoj revizionin e paditëses dhe të anuloj aktvendimin/aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.379/2021, të datës 28.07.2023 dhe ta kthejë çështjen në rivendosje.

Pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të autorizuarit të palës paditëse është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja/propozuesja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 10.07.2023, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitë padi kundër të paditurve, për konfiskimin e përhershëm të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, më saktësisht të përshkruar si në padi dhe në propozim.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur të veproj në përputhje me kërkesat e paditëses për shkak të të metave në padi, ashtu edhe në propozimin për caktimin e masës së sigurisë, prandaj me aktvendimin e datës 13.07.2023 i ka kthyer paditëses në plotësim padinë dhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë, duke kërkuar nga e njëjta që të bëjë plotësimet e kërkuara brenda afatit tre ditor pas pranimit të aktvendimit, e duke e njoftuar me pasojat ligjore procedurale të përcaktuara me nenin 102 të LPK-së.

Pala paditëse me datë 03.08.2023 ka dorëzuar në gjykatën e shkallës së parë parashtresën për plotësimin e padisë, mirëpo gjykata e shkallës së parë pas analizimit të kësaj parashtrese ka vlerësuar se pala paditëse nuk ka vepruar sipas urdhrit të gjykatës, përkatësisht nuk e ka bërë plotësimin dhe korigjimin e padisë dhe propozimin e masës së sigurisë, ashtu që e njëjta nuk është e përshtatshme për vendosje meritore dhe si të tillë e ka hedh poshtë me aktvendimin C.nr.4176/23 të datës 21.08.2023.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, i autorizuari i të autorizuarit të paditëses - propozueses ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin e saj Ac.nr.5890/23 të datës 04.10.2023, ka vendosur që të refuzoj si të pa themeltë ankesën e paditëses - propozueses, ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së dytë, pasi që aktvendimi nuk është përfshirë në shkelje

thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

I autorizuari i të paditurës në revizionin e paraqitur pretendon se ka shkelje të dispozitave procedurale, mirëpo asnjë shkelje nuk është specifikuar dhe nuk janë paraqitë arsye, andaj Gjykata Supreme është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në përputhje me dispozitën e nenit 215 të LPK-së, me ç'rast ka gjetur se aktvendimi nuk është i përfshirë në shkelje për të cilat duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pala paditëse si bazë për revizion ka përmend aplikimin e gabuar të të drejtës materiale, mirëpo në këtë rast nuk bëhet fjalë për ekzistimin e kësaj baze pasi që gjykata e shkallës së parë qysh në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë ka vërejtur se padia me masën e sigurisë përmban të meta të cilat duhet evituar nga pala paditëse në mënyrë që të mund të procedohet lidhur me çështjen. Pra gjykata nuk ka mundur të procedoj sipas padisë dhe propozimit për masë dhe nga pala paditëse është kërkuar që ato ti evitoj, mirëpo përkundër faktit që palës paditëse i është dhënë një mundësi e tillë, me shpjegime konkrete në vendimin me të cilin padia dhe propozimi për masë i është kthyer në plotësim, kjo nuk është bërë, përkatësisht është kthyer e pa korrigjuar padia me propozim për masën e sigurisë. Gjykata në këtë fazë të procedurës vetëm e ka hedh poshtë padinë e paditësit me propozim për masë për shkak se e njëjta nuk është korrigjuar nga pala paditëse dhe si e tillë ka qenë e papërshtatshme për vendosje, mirëpo nuk është vendosur për themelësinë e kërkesës, andaj në këtë fazë të procedurës nuk mund të shtrohet e as të vlerësohet çështja e aplikimit të gabuar të dispozitave materiale.

Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 222 dhe 230 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.68/2024, më datë 07.03.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari

Zenel Leku